



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 181, Datë 06.11.2020

“MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË “GSA” SH.P.K.,  
NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE”**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, gërma d) të Ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, nenit 4, pika 1, gërma e); nenit 5, pika 1, gërma e); nenit 8, nenit 9, nenit 10, pikat 1 dhe 3 dhe nenit 16 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar, si dhe nenit 19 pika 1, gërma “a” të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e datës 06.11.2020, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 118/1 Prot., datë 02.11.2020, e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes mbi kërkesën e shoqërisë “GSA” sh.p.k., për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike,

**Konstatohet se:**

- Shoqëria “GSA” sh.p.k., është mbajtëse e licencës nr. 321 Seria T11/15, së veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike që prej datës 22.06.2011, dhënë me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr.57 me afat vlefshmërie deri në datën 22.06.2016, e cila më tej është rinovuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 160 datë 28.12.2015 për pesë vjet të tjera deri në datën 22.06.2021
- Kjo shoqëri është një subjekt tregtar i krijuar si detyrim i Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar. Në datën 30.06.1993, është e rregjistruar pranë QKB, si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (sh.p.k), konform legjislacionit të kohës dhe mban NUIS përkatës.
- Në bazë të nenit 16, pika 1 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, theksohet se paraqitja e kërkesës për rinovimin e licencës nga aplikanti bëhet: (Jo më vonë se 2 muaj para përfundimit të kohëzgjatjes së vlefshmërisë së licencës së dhënë, personi mund/duhet të kërkojë në ERE rinovimin e licencës).  
Referuar sa më sipër konstatohet se shoqëria “GSA” sh.p.k, ka aplikuar brënda afatit ligjor të nevojshëm për rinovimin e licencës.
- Aplikimi i shoqërisë “GSA” sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:

- Formati dhe dokumentacioni i aplikimit (neni 9, pika 1, gërmat “a”, “b” “c”) *është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.*
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”) *është plotësuar pjesërisht.*
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal, (neni 9, pika 3 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”), *është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.*
- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.8 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”) *është plotësuar pjesërisht.*

Neni 9, pika 2

- **gërma “c”** (Vërtetim për regjistrimin dhe ekstrakt historik nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB). **plotësuar**

Për dokumentacionin e munguar që ka të bëjë me:

-Shoqëria ka përcjellë Ekstraktin historik të saj të datës 07.10.2020, i cili përmban vulë elektronike të QKB-së. Do ti kërkohet shoqërisë të përcjellë në ERE edhe çertifikatën e regjistrimit pranë QKB-së.

Neni 9, pika 4.8

- **gërma “a”, “d”** (sasia e energjisë elektrike e parashikuar për tu tregtuar në GWh / sipas viteve).  
-Shoqëria ka bërë me dije sasinë që parashikon të tregtojë për tre vite. Do ti kërkohet shoqërisë të sjellë sasinë e energjisë elektrike që parashikon të tregtojë edhe për dy vitet e tjera të veprimtarisë, do të njoftohet subjekti që në bazë të nenit 10, pika 9 dhe nenit 11, pika 1 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licensave në sektorin e Energjisë Elektrike”, e ndryshuar, t’i paraqesë këto në ERE, brënda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

**Vendosi:**

1. Të fillojë procedurën për rinovimin e licencës nr. 306, Seria FK15, të shoqërisë “GSA” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE Nr. 159, datë 28.10.2015, për një afat 5-vjeçar, duke filluar nga data 23.06.2021.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brënda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare. Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE**  
**Petrit AHMETI**